




**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME**  
Nr.01-060/01-12830/23 datë: 23.05.2023



Npi – 01/210 datë: 31.05.2023

Duke u bazuar në nenin 12.2 pika (d), nenin 2.1 dhe nenin 28 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Nenin 8 të Ligjit për Bashkëpunim Ndërkomunal Nr. 04/L-010; Neni 46.2 i Statutit të Komunës së Shtimes 01 Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më: 31.05.2023 miratoi këtë:

**V E N D I M**

**PËR MIRATIMIN E INICIATIVËS NDËRKOMUNALE  
PËR MENAGJIMIN E INTEGRUAR TË MBETURINAVE**


**I**

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -V- të rregullt për vitin 2023, të mbajtur më 31.05.2023, unanimisht miratoi Vendimin për miratimin e Iniciativës Ndërkomunale për Menagjimin e Integruar të Mbeturinave, në mes komunave si vijon:

1. Komuna Ferizaj,
2. Komuna Gjilan,
3. Komuna Kamenicë,
4. Komuna Viti,
5. Komuna Kaçanik,
6. Komuna Hani i Elezit,
7. Komuna Shtime,
8. Komuna Shtërpc,
9. Komuna Partesh,
10. Komuna Klllokot,
11. Komuna Ranillug,
12. Komuna Novobërd,

**II**

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit  
Adnan Ademi